

**VENDIM**  
**Nr. 118, datë 9.4.2024**

**AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE “GARANCIA SHTETËRORE E HUAS  
PËR SUBJEKTET E INDUSTRISË PËRPUNUESE, KATEGORIA NACE 2, PËR  
INVESTIME NË TEKNOLOGJI DHE INOVACION SI DHE PËR BLERJE TË  
LËNDËS SË PARË”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

|                     |          |
|---------------------|----------|
| Z. Blendi Gonxhja   | kryetar; |
| Znj. Mimoza Dhëmbi  | anëtare; |
| Znj. Brikena Qela   | anëtare; |
| Znj. Inida Methoxha | anëtare; |
| Z. Ahmet Mançellari | anëtar;  |

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 9.4.2024, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, mori në shqyrtim *ex-post* skemën e ndihmës shtetërore të hartuar, nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 221/2024, “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve të industrisë përpunuese, kategoria Nace 2, për investime në teknologji dhe inovacion si dhe për blerje të lëndës së parë si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”, vlerëson nëse masa është në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore.

**I. Procedura**

1. Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit dhe Agjencinë për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyer kanë hartuar vendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve të industrisë përpunuese, kategoria Nace 2, për investime në teknologji dhe inovacion si dhe për blerje të lëndës së parë si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”. Në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e ndihmës shtetërore, në bazë të planit të ndihmës shtetërore të sipërpërmendur.

**II. Përshkrimi i masës**

2. *Qëllimi*: akordimi i mbështetjes financiare ndaj sektorit të industrisë përpunuese, e cila është goditur vitet e fundit nga disa prej krizave që kanë ndikuar në ambientin ekonomik të brendshëm dhe të huaj duke u reflektuar në uljen e eksporteve. Plani i ndihmës synon të lehtësojë blerjen e makinerive, automatizimin e linjave të prodhimit, krijimin e kushteve strukturore, për të realizuar ciklin e plotë (Made in Albania), si dhe do të ketë mundësinë e disponimit të likuiditetit për nevoja të blerjes së lëndës së parë.

3. *Baza ligjore e planit të ndihmës*: plani i ndihmës shtetërore mbështetet në nenet 3 e 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024; të aktit normativ nr. 1, datë 21.2.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024” dhe ligjin nr. 55/2023 “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyer”.

4. *Kohëzgjatja*: referuar planit të ndihmës, Huamarrësi duhet të dorëzojë kërkesën e aplikimit për Hua pranë Huadhënësit jo më vonë se 31 tetor 2024. Kontratat e huas duhet të nënshkruhen jo më vonë se 31.12.2024. Afati i huas do të jetë në diskrecion të Huamarrësit, por duke mos tejkaluar në asnjë rast afatin prej 7 (shtatë) vitesh në rastin e kredive për investim dhe duke mos tejkaluar në asnjë rast afatin prej 3 (tre) vitesh në rastin e kredive për blerje të lëndës së parë.

5. *Dhënësi i ndihmës*. Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

6. *Autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës*: Agjencia për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyer.

7. *Përfituesit*: përfitues janë Huamarrësit, të cilët duhet të jenë subjekt që zhvillon aktivitetin e tij në fushat të cilat zhvillohen bazuar në klasifikimin Nace 2 sipas përcaktimit në aneksin 2 të Marrëveshjes së Garancisë. Huamarrësi duhet të jetë subjekt i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me ligjin 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, dhe struktura e kapitalit të zotërohet 100% nga subjekte jopublike. Huamarrësi nuk duhet të ketë detyrime tatimore të papaguara në momentin e aplikimit. Huamarrësi nuk duhet të ketë kredi me probleme, me vonesa prej më shumë se 60 ditë, në historik dhe në momentin aktual në Regjistër Kredie. Huamarrësi nuk duhet të ketë detyrime në historik dhe në momentin aktual ndaj Ministrisë së Financave që rrjedhin nga Skema të mëparshme të Garancive Shtetërore miratuar me VKM nr. 277, datë 6.4.2020, VKM nr. 387, datë 13.5.2020 dhe VKM nr. 349, datë 26.5.2022”.

8. *Shtirja sektoriale dhe territoriale*: Projekti do të zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë Nëpërmjet kësaj mbështetje, Sektori i Industrisë Përpunuese mund të lehtësohet për blerjen e makinerive, automatizimin e linjave të prodhimit, krijimin e kushteve strukturore, për të realizuar ciklin e plotë (Made in Albania), si dhe do të ketë mundësinë e disponimit të likuiditetit për nevoja të blerjes së lëndës së parë. Sektori i Industrisë Përpunuese është goditur vitet e fundit nga disa prej krizave që kanë ndikuar në ambientin ekonomik të brendshëm dhe të huaj duke u reflektuar në uljen e eksporteve. Për të tejkaluar këtë situatë, sektori ka nevojë të përmirësojë dhe përditësojë proceset teknologjike që përdor, të rrisë nivelin e produktivitetit dhe konkurueshmërisë në tregjet ndërkombëtare.

9. *Forma dhe vlera e ndihmës*: vlera e ndihmës shtetërore në formën e garancisë shtetërore është në vlerën 4 000 000 000 (katër miliardë) lekë. Vlera e huas që do të vendoset në dispozicion nga Huadhënësi për Huamarrësin mund të variojë në përputhje me kërkesën e paraqitur nga Huamarrësi, por në asnjë rast kreditë e dhëna për huamarrësin nga bankat, sipas Marrëveshjes së Garancisë, nuk do të jetë më e lartë se 100,000,000 (njëqind milionë) lekë.

### **III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore**

10. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

11. Neni 4, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

*“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në fjarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.*

12. Gjithashtu neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë,<sup>1</sup> përcakton se:

*“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”*

13. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore, b) avantazhi ekonomik, c) përzgjedhja dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes së stabilizim-asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.

14. Plani i ndihmës aktivizon burime shtetërore, duke qenë se administrohet nga buxheti i shtetit. Plani ndihmës i jep një avantazh përfituesve në formën e garancive për huat, të cilat do të jenë në kushte më të favorshme se kushtet e tregut. Plani i ndihmës i lehtëson përfituesit për koston e huas që do të duhet të paguanin në kushte normale të tregut. Avantazhi i dhënë nga masa është selektive, pasi plani i ndihmës do të jetë i zbatueshëm vetëm në sektorin e industrisë përpunuese dhe do të akordohet vetëm për ndërmarrjet që përmbushin kritere të caktuara të planin e ndihmës.

Në këto kushte Komisioni vlerëson se plani në shqyrtim është ndihmë shtetërore.

#### **IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës**

15. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson planin e ndihmës në përputhje me nenin 8/1, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, i cili parashikon se Ndhma shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të lejohet, përfshirë ndihmë për investime.”

16. Mbështetur në pikën 1, të nenit 5, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”, ndihma është transparente kur ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi përpara dhënies së ndihmës, duke vlerësuar paraprakisht konkurrencën në tregun përkatës, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në këtë rregullore. Në bazë të pikës 2, të nenit 5, të VKM-së nr. 513/2018, ndihma transparente në formën e garancisë, konsiderohet kur:

- përfituesi i ndihmës nuk përmbush kushtet për nisjen e një procedure falimentimi sipas legjislacionit në fuqi; dhe

- garancia nuk kalon 80% të kredisë që garanton dhe pjesa e garantuar e kredisë nuk kalon shumën prej 522 500 000 (pesëqind e njëzet e dy milionë e pesëqind mijë) lekësh;

Referuar planit të ndihmës të dy kushtet e sipërcituara përmbushen, sepse huamarrësi nuk duhet të ketë detyrime tatimore të papaguara në momentin e aplikimit dhe se nuk duhet të ketë kredi me probleme, me vonesa prej më shumë se 60 ditë, në historik dhe në momentin aktual në Regjistër Kredie.

17. Mbështetur në nenin 11, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”, ndihma për investime, lejohet nëse kostot e pranueshme përfshijnë kostot e investimit në asete të prekshme dhe të paprekshme dhe/ose kostot e parashikuara të pagave në lidhje me punësimin e krijuar drejtpërsëdrejti nga projekti i investimit, të përlllogaritura gjatë një periudhe dyvjeçare. Një investim konsiderohet si kosto e pranueshme, me kusht që të jetë: blerje e aseteve, që i përkasin një ndërmarrjeje, në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

*i. ndërmarrja është mbyllur ose do të mbyllet nëse nuk do të ishte blerë;*

*ii. asetet janë blerë nga një palë e tretë që nuk ka lidhje me blerësin;*

*iii. transaksioni është kryer në përputhje me kushtet e tregut.*

Referuar planit të ndihmës, ndihma mund të jepet për blerjen e makinerive, automatizimin e linjave të prodhimit si dhe krijimin e kushteve strukturore për të realizuar ciklin e plotë (Made in Albania), investim i cili duhet të jetë në përputhje me kushtet e tregut.

18. Në bazë të nenit 6, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”, ndihma konsiderohet të ketë efekt nxitës nëse përfituesi ka dorëzuar një aplikim me shkrim për ndihmën shtetërore pranë dhënësit të ndihmës shtetërore, para fillimit të punimeve projektit ose aktivitetit. Aplikimi për këtë ndihmë duhet të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe madhësinë e ndërmarrjes;

b) përshkrimin e projektit, përfshirë datat e fillimit e përfundimit të tij;

c) vendndodhjen e projektit;

ç) listën e kostove të projektit;

d) llojin e ndihmës (grant, hua, garanci, paradhënie ose në formë tjetër) dhe shumën e fondit publik që nevojitet për projektin.

Plani i ndihmës ka efekt nxitës, sepse referuar nenit 3, të projektvendimit të KM-së, parashikohet se *“Huamarrësi duhet të dorëzojë kërkesën e aplikimit për Hua pranë Huadhënësit jo më vonë se 31 tetor 2024. Kontratat e huas duhet të nënshkruhen jo më vonë se 31.12.2024”*.

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 513, datë 4.9.2018 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”, ndihma për investime mund lejohet, nëse përmbushen si vijon:

- Një investim konsiderohet si kosto e pranueshme, me kusht që të jetë:

a) Një investim në asete të prekshme dhe/ose të paprekshme për ngritjen e një ndërmarrjeje të re apo zgjerimin e një ndërmarrjeje ekzistuese, për të diversifikuar prodhimin e një ndërmarrjeje me produkte të reja shtesë ose një ndryshim rrënjësor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të një ndërmarrjeje ekzistuese; ose

b) Blerje e aseteve, që i përkasin një ndërmarrjeje, në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. ndërmarrja është mbyllur ose do të mbyllet nëse nuk do të ishte blerë;

ii. asetet janë blerë nga një palë e tretë që nuk ka lidhje me blerësin;

iii. transaksioni është kryer në përputhje me kushtet e tregut.

- Asetet e paprekshme duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) të përdoren vetëm në ndërmarrjen që ka përfituar ndihmën;

b) të konsiderohen si asete të amortizueshme;

c) të blihen, në përputhje me kushtet e tregut, nga një palë e tretë, që nuk ka lidhje me blerësin;

ç) të përfshihen në asetet e ndërmarrjes për të paktën tre vjet.

- Vendet e punës të krijuara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projekti i investimit duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të krijohen brenda tre vjetëve nga koha e përfundimit të investimit;

b) rritjen neto të numrit të punonjësve në ndërmarrjen në fjalë, në krahasim me mesataren e 12 muajve të mëparshëm;

c) vendet e punës duhet të ruhen për një periudhë minimale tre vjeçare nga data e plotësimit për herë të parë.

Referuar planit të ndihmës, qëllimi i përdorimit të fondeve të huas është për t'i mundësuar Huamarrësit fondet e nevojshme për investime në teknologji dhe inovacion si dhe për blerje të lëndës së parë dhe se në asnjë rast fondet e huas nuk do të financojnë veprimtari të jashtëligjshme, apo të rifinancojnë hua të tjera.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 8/1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

#### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 8/1, 22, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

#### VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve të industrisë përpunuese, kategoria Nace 2, për investime në teknologji dhe inovacion si dhe për blerje të lëndës së parë të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 221/2024 *“Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve të industrisë përpunuese, kategoria Nace 2, për investime në teknologji dhe inovacion si dhe për blerje të lëndës së parë si edhe për përcaktimin e kushteve e të kritereve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”*.

2. Përfituesi i ndihmës të sigurojë përmbushjen e kushteve si vijon:

- Një investim konsiderohet si kosto e pranueshme, me kusht që të jetë:

a) Një investim në asete të prekshme dhe/ose të paprekshme për ngritjen e një ndërmarrjeje të re apo zgjerimin e një ndërmarrjeje ekzistuese, për të diversifikuar prodhimin e një ndërmarrjeje

me produkte të reja shitesë ose një ndryshim rrënjësor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të një ndërmarrjeje ekzistuese; ose

b) blerje e aseteve, që i përkasin një ndërmarrjeje, në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. ndërmarrja është mbyllur ose do të mbyllet nëse nuk do të ishte blerë;

ii. asetet janë blerë nga një palë e tretë që nuk ka lidhje me blerësin;

iii. transaksioni është kryer në përputhje me kushtet e tregut

- për asetet e paprekshme duhet të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- të përdoren vetëm në ndërmarrjen që ka përfituar ndihmën;

- të konsiderohen si asete të amortizueshme;

- të blihen, në përputhje me kushtet e tregut, nga një palë e tretë, që nuk ka lidhje me blerësin;

- të përfshihen në asetet e ndërmarrjes për të paktën tre vjet;

- vendet e punës të krijuara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projekti i investimit duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të krijohen brenda tre vjetëve nga koha e përfundimit të investimit;

- rritjen neto të numrit të punonjësve në ndërmarrjen në fjalë, në krahasim me mesataren e 12 muajve të mëparshëm;

- vendet e punës duhet të ruhen për një periudhë minimale tre vjeçare nga data e plotësimit për herë të parë.

3. Agjencia për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyera brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e monitorimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura në përputhje me nenin 9, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore" si vijon:

a) informacionin përmbledhës të referuar në formatin e standardizuar të përcaktuar në shtojcën I ose *link*-un e informacionit;

b) tekstin e plotë të çdo mase ndihme ose *link*-un e tekstit të plotë;

c) informacionin e referuar në shtojcën II për çdo dhënie të ndihmës individuale që i tejkalon 500 000 (pesëqind mijë) euro.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

## KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

**Kryetar:** Blendi Gonxhja

**Anëtarë:** Mimoza Dhëmbi, Brikena Qela, Inida Methoxha, Ahmet Mançellari